

KONTROLLORËT E RINJ TË ALBCONTROL

10 studentë të fushave të ndryshme, janë përzgjedhur përmes një procesi tejet transparent për t'u bërë kontrollorë të trafikut ajror. Afro 300 të rinj aplikuan për t'u bërë pjesë e këtij procesi. Testimi u zhvillua në disa faza, zgjati afro 3 muaj, ashtu siç parashikon FEAST dhe i gjithë procesi u monitorua nga EUROCONTROL. 10 studentët e përzgjedhur tashmë do të nisin akademinë "Entry Point North", në Madrid për t'u diplomuar si kontrollorë të trafikut ajror.

CERTIFIKOHET "AIR ALBANIA"

Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar lëshoi çertifikatën e operimit për kompaninë ajrore, mbajtëse të flamurit "Air Albania". Procesi intensiv dhe rigoroz, duke pëmbushur të gjitha standardet e kërkuara, u realizua brenda një kohe rekord. Fillimisht, fluturimet do të nisin me destinacion aeroportin e ri të Stambollit, ndërsa me mbërritjen e avionit të dytë kompania do të ofrojë fluturime edhe në Itali e Londër. Futja në treg e kompanisë ajrore "Air Albania" ka si synim uljen e çmimit të biletave për fluturimet nga Shqipëria.

ANULOHEN DY HEC-E NË LUMIN URAKË

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur anulimin e ndërtimit të dy HEC-eve të parashikuar për t'u ngritur në lumin Urakë, në zonën e Kurbneshit në Mirditë. Vendimi erdhi pas shqetësimit të ngritur nga banorët e zonës, të cilët iu drejtuan Platformës së Bashkëqeverisjes shqipëriaqeduam.al. Zona në fjalë është shpallur zonë e mbrojtur, ndaj nuk do të lejohet ndërtimi i hidrocentraleve në të.

PARKU FOTOVOLTAIK NË TOPOJË TË FIERIT

Pesë licenca për prodhimin e energjisë së rinovueshme janë bashkuar duke krijuar në Topojë të Fierit në një park fotovoltaik i cili prodhon në tërësi 10 megavat energji. Ky bashkim ka bërë që për të 5 licensat të përdoret i njëjtin sistem monitorimi dhe i njëjti rrjet shpërndarjeje duke ulur në mënyrë të ndjeshme kostot. Parku është kthyer në një model suksesi për të gjithë të interesuarit të cilët duan të investojnë në këtë sektor.

RINAS - KASHAR, PËRFUNDON FAZA E PARË E NDËRHYRJES

Ka përfunduar faza e parë e ndërhyrjes emergjente në kryqëzimet e Laknasit dhe Domjes, në aksin rrugor Kashar-Rinas. Plotësimi me sinjalistikë vertikale dhe horizontale rrit sigurinë rrugore në këtë aks ndërsa po punohet për implementimin e një projekti të qëndrueshëm, i cili rregullon gjeometrinë e rrugës përmes një rrethrotullimi.

RIKONSTRUKSION 6 KABINAVE ELEKTRIKE NË TIRANË

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka marrë masa për transformimin e rrjetit elektrik dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike për abonentët e Tiranës. Gjatë kësaj jave u bë e mundur rikonstruksioni i gjashtë kabinave, në pjesën ndërtimore dhe elektrike, me pajisje të reja dhe të sigurta. Drejtoria Rajonale e OSHEE-së Tiranë do të vijojë me investimin deri në përfundimin e plotë të projektit.